



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.05.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së AKEP-it për vitin 2018. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglandina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Lefter Koka, Rrahman Rraja dhe Gjetan Gjetani.

Të ftuar:

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e draftrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së AKEP-it për vitin 2018”.

Relatore e draftrezolutës është zonja Eglantina Gjermeni.

Fjala është për ju, zonja Gjermeni.

Eglantina Gjermeni - Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e bëmë dëgjuesën me drejtorin e AKEP-it dhe diskutuam në lidhje me raportin e punës për vitin 2018. Vlerësuam të gjitha arritjet që janë bërë, duke i krahasuar me detyrat që kishim lënë në rezolutën e vitit të kaluar, ndërkohë që kemi bërë disa rekomandime dhe detyra për AKEP-in për vitin që vjen.

Meqenëse këto i diskutuam në mbledhjen e kaluar, dua të fokusohem kryesisht te draftrezoluta, që të gjithë e keni marrë me *email* dhe e keni përpara në tavolinë të cilën kemi menduar për ta diskutuar dhe për ta aprovuar të gjithë së bashku.

Nuk do ta lexoj të gjithë projektrezolutën, por do të fokusohem vetëm në disa çështje që më duken të rëndësishme dhe, pa diskutim, kërkoj mbështetjen dhe sugjerimet tuaja për ta përmirësuar atë.

E kemi filluar me vëmendjen e veçantë që AKEP-i duhet t'i kushtojë vendimmarrjes në lidhje me analizën e tregut celular, tregut me shumicë, aksesit dhe origjinimit, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregut me pakicë të shërbimeve celulare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

AKEP-i duhet të vijojë punën, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, për ndjekjen e procedurave të tenderimit, në lidhje me dhënien në përdorim edhe të dy brezave të tjerë të lirë të frekuencave 800 megahertz për t'u hapur rrugë futjes së teknologjive dhe shërbimeve të reja *mobile* në nivel kombëtar.

Ajo që dua të theksoj, është se duhet të punojë për implementimin e teknologjive të reja nëpërmjet politikave rregullatore, të cilat sjellin rritjen e konkurrencës përmes rritjes së cilësisë, si dhe ndikojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira dhe më efiente në tregun e komunikimeve elektronike.

Të bashkëpunojë me aktorët brenda vendit dhe ata ndërkombëtarë për implementimin me sukses të marrëveshjeve për lehtësimin e tarifave të *roaming* me Kosovën

dhe më tej për vijimin e hapave dhe procedurave për lehtësimin e tarifave *roaming* me vendet e Ballkanit, sipas marrëveshjeve të nënshkruara. Këtu dua të theksoj se ne e vlerësuam në mbledhjen e kaluar se çfarë është bërë nga AKEP-i për *roaming* me Kosovën, që fillon në qershor të këtij viti. Sigurisht, duam ta vazhdojmë këtë edhe me vendet e tjera të rajonit.

Ndërkohë, disa nga shqetësimet në punën e AKEP-it dhe të të gjitha telefonive celulare për sa u përket shërbimeve ndaj konsumatorëve i kemi theksuar. Këtu dua të ndalem: të vijojnë monitorimet, që kanë në fokus matjen e nivelit të rrezatimeve të telefonisë celulare, duke adresuar shqetësimin e publikut, në lidhje me ekspozimin e valëve elektromagnetike të telefonave celularë, stacioneve bazë dhe transmetuesve të tyre, në mënyrë që niveli i këtyre rrezatimeve të mos e tejkalojë pragun e sigurisë së përcaktuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jo-jonizuese.

Gjatë vitit 2019 AKEP-i të bëjë një vlerësim të strukturës së tregjeve të shërbimeve postare, duke i dhënë rëndësinë e duhur edhe shërbimit postar, si dhe të ketë në fokus garantimin e shërbimit universal postar dhe cilësisë së shërbimeve postare në të gjithë territorin e vendit, duke i kushtuar vëmendje zgjidhjes së problemeve të identifikuara lidhur me saktësinë e adresave dhe shpërndarjes së pakove në bashkëpunim dhe me institucionet përkatëse.

Të intensifikojë aktivitetin e tij nëpërmjet grupit të punës, i cili është ngritur në vitin 2018 në lidhje me kushtet teknike të zbatuara nga operatorët, si dhe të zbatojë masa administrative, sipas ligjit, në rastet e shkeljeve, duke e konsideruar problemin e kabllave ajrore apo atyre të vendosura në shtyllëzimet elektrike, si dhe përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, si një problem që vijon të mbetet shqetësues.

Të punojë për ngritjen e një regjistri “*do not call me*”, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare për të rregulluar aktivitetin e telemarketuesve, që bëjnë thirrje telefonike të padëshiruara për individë privatë. Skema e regjistrimit do të mundësojë përdoruesit që të bëjnë opt-out, pra të kenë opsionin të mos marrin thirrje të pakërkura nga kompanitë telemarketing.

Dua të përmbyll fjalën time duke iu thënë që duhet të bashkëpunohet me institucionet e tjera shtetërore për të bërë të mundur finalizimin e zbatimit të përdorimit të numrit të emergjencës 112, në të gjithë Shqipërinë, deri në fund të vitit 2019, kërkesë e cila theksohet edhe në raportin progresin e Komisionit Europian.

Të gjitha rekomandimet që kemi bërë janë të bazuara në problematikat, të cilat janë vënë re edhe në monitorimin që ne si komision i kemi bërë AKEP-it apo edhe shqetësimeve të konsumatorëve që kanë ardhur te ne si komision. Mendoj se i kemi adresuar të gjitha

shqetësimet dhe të jemi korrektë në adresimin e tyre me detyrat që i kemi lënë AKEP-it. Çdo koment dhe sugjerim juaji është i mirëpritur, në mënyrë që ta pasurojmë dhe ta bëjmë dokument pune.

Faleminderit!

Niko Peleshi- Faleminderit, zonja Gjermani!

A ka diçka për të shtuar lidhur me projektrezolutën?

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Së pari, unë mendoj se, përveç përpjekjeve për të stabilizuar situatën aktuale, deri diku kaotike të rrjeteve nëpër qytetet tona, duhet të rekomandojmë këtë vit, ndoshta duhet ta shtrijmë edhe jashtë rezolutës, vendosjen e standardeve të reja në ndërtime. Domethënë, në vitin 2020 duhet që në momentin kur ndërtohet një pallat, ashtu siç ka vendin e ujit të pijshëm dhe vendin e energjisë, duhet të këtë edhe vendin ose hapësirën për infrastrukturën e të dhënave. Është e vërtetë që po shkohet shumë drejt rrjeteve wireless, por të paktën deri në godinë.... Edhe me pallatet e reja që mbarojnë sot, pasi mbaron pallati, fillojnë historitë dhe kontradiktat për administrimin e pallateve.

Ndoshta nuk është vendi këtu, sepse nuk është AKEP-i ai që duhet të ndryshojë rregullat për dhënien e një leje ndërtimi, por duhet të nxisim AKEP-in dhe ne, si komision, të vazhdojmë edhe me çështjet e tjera. Nëse sot aksesimi në komunikimin me brez të gjerë po kthehet në një nevojë bazike për familjet tona, duhet që të punojmë që në këtë moment. Aty ku ndërtohet një pallat, të paktën në një sipërfaqe të caktuar, një kolonë, siç është ajo e ujërave dhe e energjisë, të jetë edhe për wireless. Në paragrafin ku jepen detyra, ndoshta mund të shtohet një fjali edhe për këto.

Kam një koment për paragrafin, ku kërkohet të vijojnë monitorimet, të cilat kanë në fokus matjen e rrezatimeve nga shqetësimi i qytetarëve. Ka një ent shtetëror, që me ligj e ka për detyrë ta bëjë këtë punë, që është Komiteti për Mbrojtjen e Rrezatimeve, i cili funksionon me një ligj të veçantë dhe është pranë Institutit të Shëndetit Publik. Unë di që ai komitet drejtohet nga ministri i Shëndetësisë dhe ndoshta ka pasur përplasje mes drejtorësh, por duhet të bashkëpunojmë me Komitetin për të arritur këtë qëllim. Ne kemi një ligj në Shqipëri, i cili ka vendosur se kush e ka detyrë ta bëjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Raporti që del për monitorim, që të ketë bazë ligjore, sanksione dhe detyrime, duhet të firmoset nga një specialist, ekspert që njihet nga KMR-ja si i tillë. AKEP-i mund të bëjë një matje, por për sa kohë ajo matje nuk është bërë nga një person që ka autoritetin ligjor për

ta bërë, mund të jetë matje që ngelet në nivelin e këshillimit, por që ajo të imponojë operatorët që të reagojnë dhe të bëjnë ndryshimet e nevojshme, se nuk është vetëm puna e sanksioneve. Do të ndryshojnë teknologjinë etj. E di ai se çfarë bën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nejse. Ka një institucion që me ligj, e bën këtë punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di. Nuk e kam idenë. Këta njerëz që licencohen, kanë pajisjet dhe janë si privatët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Përderisa bëhen monitorime, do të thotë që ai e mbështet diku atë që bën monitorimin.

Eglantina Gjermani – Patjetër.

Arben Pëllumbi – Se sa forcë ka imponimi i monitorimit që ai bën, ne nuk jemi në gjendje ta themi, por mund të shtojmë në rezolutë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Këtë gjë e bëjnë institucionet përkatëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Interesi publik i qytetarëve për këtë punë, zgjidhet nga një ligj i veçantë dhe ka një ent që ekziston për këtë punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. Ai është ligj për shëndetin, ndërsa ky është ligj për komunikimet elektronike.

Eglantina Gjermani – Mund ta shtojmë, ta vëmë “në bashkëpunim”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj - Kam frikë, nuk e di se sa përmbushet brenda vitit rekomandimi i fundit për 112-n, se janë shumë mbrapa.

Këtu, te 112-ta është edhe një problem tjetër, sipas mendimit tim, të paktën nga ajo kohë kur kam punuar në shëndetësi. Problemi kryesor që duhet ta ketë çdo urgjencë, është se operatorët celularë sot e kanë të ndaluar të tregojnë vendndodhjen nga vjen thirrja, ndërkohë që një urgjencë që i duhet patjetër që për të lokalizuar shpejtësinë e përgjigjes (e di këtë nga urgjenca mjekësore, por e njëjta gjë duhet të jetë edhe për zjarrfikësit apo për një gjë tjetër). Ne filluam atëherë përpjekjen për të bërë ndryshimin e ligjit, por nuk arritëm ta bënim.

Bota e zhvilluar sot është përpjekur ta zgjidhë me faktin që sot ka aplikacione që instalohen në celular dhe ti si përdorues i këtij aplikacioni ke pranuar që me këtë aplikacion, kur i bie 112-s, ke pranuar të ndash me të gjeolokalizimin tënd. Sot për sot në Shqipëri është ende e pazgjidhur dhe ndoshta këtë duhet t'i kërkojmë, ta shtojmë rekomandimin edhe për ta zgjidhur çështjen në nivel ligjor, sepse thjesht thirrja dhe pastaj ata që vijnë vërdallë për të gjetur se ku është, si, qysh, tek, për sa kohë që ne edhe adresarin nuk e kemi ende të plotë. Sidomos, kur vijnë thirrjet nga zonat larg zonave urbane, se në këto të fundit bëhet pak më e lehtë, ndoshta këtu përveçse duhet ta zbatojmë për numrin 112. Nuk e di sa janë gati institucionet për ta arritur brenda vitit, sepse këtu është edhe zjarrfikësi, edhe policia, edhe shëndetësia. Nuk e di nëse ka ndonjë tjetër, por të paktën këta 3 aktorë janë patjetër. Shëndetësia vazhdon ende me numrin 127, sepse akoma nuk është unifikuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më duket se vazhdojnë ta marrin edhe me një numër fiks të vitit 1989, sepse shumë njerëz vazhdojnë ta kenë atë numër fiks, por u duhet thënë që ai ta rutojë në...

Këto shqetësime kisha unë.

Eglantina Gjermani – Çfarë do të shtonim këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj - Në pikën e fundit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Arben Pëllumbi – Desha të them se keni plotësisht të drejtë, por në pikën e fundit kam përshtypjen se gjeolokalizimin, nëse 112-ta duhet ta bëjë me siguri do ta bëjë nëpërmjet GPS-së dhe jo trekëndëshit të antenave celulare. Kjo është një çështje shumë teknike që ne nuk mund t'ia shkruajmë në rezolutë.

Ilir Beqaj – Jo, ndoshta ne nuk shkruajmë në rezolutë si ta bëjë ...

(Mungesë incizimi)

Përfshirë identifikimin e vendndodhjes nga vjen thirrja dhe pastaj ...

Nga eksperiencia që ju keni ...

Eglantina Gjermani – Nuk e di nëse e bëjmë dot brenda vitit 2019. Nëse e shtojmë këtë pjesë ...

Ilir Beqaj – Çfarë mendimi ke për pjesën e parë të ndryshimit të kushteve të lejes së ndërtimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është çështje e ministrisë dhe komisionit tonë më shumë

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdojmë gjithmonë me këto histori. Legalizojmë rrjete që të bëhen ..., ndërkohë që privati do të ecë dhe nuk na pret ne që të rregullohemi.

Marlind Myftiu – Kam përshtypjen që bashkia e Tiranës e ka rregulluar këtë gjë. Në lejen që jep janë të gjitha linjat e përcaktuara. Duhet ta kesh patjetër edhe linjën “Data”

Ilir Beqaj – Pyeta dy arkitektë para se të vija në mbledhje dhe më thanë se nuk ju imponohen kur bëjnë projekte. Ju imponohen për energjinë, ujin, ujërat e zeza. Varet nga investitori, tha. Ka investitorë që ...

Niko Peleshi – Normalisht i takon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që ta nxisë. Për shembull, para pak kohësh, kur e keni drejtuar ju, zonja Gjermani, më kujtohet se kemi bërë rregullimet për personat me aftësi të kufizuara. Ka qenë iniciativë e ministrisë.

Eglantina Gjermani – Ka qenë në ligj, por ne e morën në konsideratë tek të gjitha projektet e rilindjes urbane. Ishim shumë strikt me kriteret e vlerësimit, pavarësisht se ligjin jo të gjithë e zbatojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Nuk jam i sigurt nëse mund të futet në rezolutë. Mund të bëni ju një kontroll nëse e ka këtë fushë AKEP-i?

Marlind Myftiu – Për pjesën e projektit të godinës, AKEP-i nuk ndërhy, kurse kur projekti dërgohet për të marrë leje në bashki, krahas pjesës së ujërave të zeza, shkarkimet dhe pjesët elektrike, ka edhe pjesën e telefonisë.

Ilir Beqaj – Nuk e ka.

Marlind Myftiu – E ka.

Ilir Beqaj – Unë fola me arkitektë para se të vija në mbledhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Marlind Myftiu – Flas për linjat e telefonisë

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ajo pastaj ka problem me të drejtën e kalimit.

Niko Peleshi – Ka ndonjë gjë tjetër?

Nimet Musaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja Gjermani!

Të nderuar kolegë,

Dua të shpreh dy vlerësime për këtë projektrezolutë.

Së pari, shpreh konsideratën time për heqjen e tarifës e roaming-ut me Kosovën, është një lajm shumë i mirë dhe mendoj që kjo gjë duhet bërë edhe me vendet e tjera të Ballkanit.

Meqenëse jemi në këtë pikë dhe kemi përfaqësuesin këtu, dua të bëj edhe një pyetje.

Në një nga pikat ku vlerësohet puna për vitin 2019, thuhet: të merren masa, që qytetarët, konsumatorët të mos paguajnë tarifa dhe kosto shtesë për marrjen e pakove nga Posta Shqiptare, praktikë sipas së cilës qytetarët duhet të shkojnë e ta tërheqin dërgesën në zyrën e postës kundrejt një pagese, në vend që ta marrin me adresë.

Jemi në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. A ka ndonjë afat?

E dyta: nëse është aplikuar, si ka ecur kjo punë? Si mendohet, që në të ardhmen t'u vijmë në ndihmë qytetarëve për lehtësirat që ata duan?

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Në fakt, përfaqësuesit e AKEP-it nuk janë sot, por gjatë raportimit që ata bënë mbledhjen e kaluar, unë u bëra pyetje të veçantë në lidhje me shërbimet postare, sepse gjithmonë i kushtojmë vëmendje më shumë telefonisë celulare se sa shërbimeve postare. Duke pasur parasysh shtrirjen në vend, aksesin që kanë qytetarët, sidomos ata në zonat e thella rurale, si dhe pensionistët, të cilët e përdorin shumë shërbimin postar, e vendosëm këtë për vitin 2019, si pjesë e rëndësishme për punën e AKEP-it, që të monitorojë edhe punën e shërbimit postar.

Pra, është e re. E kemi pasur vitin e kaluar vëmendjen ndaj shërbimit postar, por tani e vendosëm në mënyrë eksplicite, nisur edhe nga shqetësimet e ardhura prej qytetarëve. Kësisoj, AKEP-it i kërkojmë që të marrë një rol më proaktiv edhe ndaj Postës Shqiptare, për të garantuar shërbimin universal postar, si dhe kosto sa më të ulët për qytetarët. Është detyrë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë duhet ta vendosim në mënyrë eksplicite, që brenda 2019-ës këtë detyrë ia kërkojmë AKEP-it. Do të shtojmë vetëm pjesën: “brenda vitit 2019”.

Faleminderit!

Nimet Musaj – Më fal, kryetar! Duke dëgjuar kolegun Beqaj në propozimin që bëri, në lidhje me momentin nga vjen thirrja nga operatori, si mendoni se mund të procedohet, që t'u vijmë sa më shpejt në ndihmë me specialistë, me njerëz, që të na e sjellin sa më shpejt edhe këtë propozim të kolegut?

Faleminderit!

Ilir Beqaj – Besoj se neve nuk na pengon njeri, që të marrim vetë iniciativë ligjore dhe të propozojmë një amendament. Unë mbaj mend se para tre vjetësh, nëse ju kujtohet dhe juve, erdhi një herë si propozim në qeveri, por pastaj fusha u zgjerua shumë më tepër dhe ngeli në atë pikë. Pastaj, ndoshta u pengua, jo për këtë propozim, por për nja dy propozime të tjera. Fillimisht, ne mund të fokusohemi vetëm në këtë pjesë.

Eglantina Gjermani – Ta marrim si nismë ligjore?

Ilir Beqaj – Po, të propozojmë një nismë ligjore. Ne s'na pengon njeri për këtë gjë. Unë mbaj mend, ngaqë më është dashur për shëndetësinë, se atëherë Turqia e kishte në Kushtetutë këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur thërret urgjencën. Pra, kur thërret urgjencën, ti ke pranuar se ke hequr dorë nga privatësia jote. Sot bota e zhvilluar e ka zgjidhur tashmë. Kur e instalon këtë *app* dhe e përdor, kur bën thirrjen çon edhe të dhënat se ku je.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermani – Më falni, nëse mund të them diçka! Unë jam shumë dakord, që edhe ne ta marrim si nismë ligjore. Nuk e di në cilin emision televiziv kam parë që i bënin thirrje policisë, ndonjëherë edhe talleshin me të, pra ishte alarm i rremë.

Tani, në momentin që thërret shërbimin e urgjencës, shërbimin e policisë ose zjarrfikësit, patjetër që ka humbur privatësia jote dhe do t'i marrësh vetëm kur ke nevojë. Në qoftë se ka hapësirë ligjore për ta bërë, mund ta bëjmë.

(Deputeti Beqaj ndërhyr pa mikrofon.)

Ilir Beqaj – ...kemi sot kontraktime ajrore goxha më të pastra dhe të sakta, në krahasim me shumë vite më parë.

Niko Peleshi – Atëherë, a ka ndonjë vullnetar që ta ndjekë si nismë, apo ta mbajmë shënim dhe ta çojmë përpara ne si komision?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ofrohem unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord. Atëherë, zoti Beqaj do të vlerësojë nevojën e kësaj nisme dhe, në qoftë se do të shihet e nevojshme, do ta përkthejmë në një iniciativë ligjore të komisionit tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka ndonjë koment tjetër, ose plotësim për projektrezolutën, para se zonja Gjermani të bëjë një prezantim të ndryshimeve të propozuara, në mënyrë që ta votojmë bashkë me ndryshimet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, të nderuar kolegë!

Do të përmend vetëm dy-tri gjëra.

Së pari, te monitorimi, lidhur me matjen e nivelit të rrezatimeve të telefonisë celulare, duhet të themi: “në bashkëpunim me Komisionin Kombëtar për Mbrojtjen...”, se, në fakt, komisioni ndërkombëtar ka përcaktuar nivelin, ndërsa Komisioni i Mbrojtjes së Rrezatimit, që është këtu, si institucion, në bashkëpunim të plotë...

Lidhur me sugjerimin e zotit Musai për ta vendosur “brenda vitit 2019”, pra për sa u përket masave, në mënyrë që konsumatorët të mos paguajnë tarifa dhe kosto shtesë për marrjen e pakove (dërgesave nga Posta Shqiptare), ta bëjmë në mënyrë eksplicite “brenda vitit 2019”.

E fundit, te pjesa ku flitet për bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore për të bërë të mundur finalizimin e zbatimit të përdorimit të numrit të emergjencës 112, përfshirë identifikimin e vendndodhjes nga vjen thirrja.

Për sa i përket vitit, unë do të sugjeroja sërish që të jetë ambicioze që të bëhet brenda vitit 2019, ndërkohë që ne të monitorojmë dhe do të shikojmë se si ecën puna pastaj. Faleminderit!

(Zoti Myftiu ndërhyrje pa mikrofon.)

Marlind Myftiu – ...nuk ka pasur objeksione për sa kemi shkuar ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord.

Kush është dakord me miratimin e projektrezolutës, së bashku me ndryshimet, që sapo citoi relatorja?

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektrezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2018”, e cila do të prezantohet dhe do të votohet në seancën plenare.

Faleminderit!

A kemi ndonjë çështje tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse nuk kemi çështje të tjera për t'u trajtuar, e konsideroj mbledhjen të mbyllur.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA